



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 25

Tiranë – E enjte, 18 shkurt 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Urdhër i Kuvendit nr. 10, datë 11.2.2016	Për delegimin e kompetencave..... 2277
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 91, datë 10.2.2016	Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga Fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, për vitin 2016..... 2277
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 99, datë 10.2.2016	Për emërim në detyrë..... 2279
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 100, datë 10.2.2016	Për emërim në detyrë..... 2280
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 101, datë 10.2.2016	Për emërim në detyrë..... 2280
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 102, datë 10.2.2016	Për emërimin në detyrë të prefektit të qarkut të Lezhës..... 2280
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 103, datë 10.2.2016	Për miratimin e planit të mobilizimit të përgjithshëm ose të pjesshëm të burimeve njerëzore e materiale të vendit gjatë periudhës për të cilën kërkohet vendosja e masave të jashtëzakonshme..... 2280
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 104, datë 10.2.2016	Për kalimin në pronësi të Bashkisë Berat, të pasurisë me nr. 2953, me sipërfaqe 5 670 m ² , në zonën kadastrale 8505, Berat, dhe për një shtesë në vendimin nr. 834, datë 21.11.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Berat, të qarkut të Beratit”, të ndryshuar..... 2282

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 106, datë 10.2.2016	Për miratimin e rregullores “Për funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”.....	2283
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 107, datë 10.2.2016	Për një shtesë në vendimin nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet, që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar.....	2290
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 108, datë 10.2.2016	Për disa ndryshime në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 1657, datë 24.12.2008; nr. 100, datë 27.1.2009; nr. 286, datë 18.3.2009; nr. 450, datë 6.5.2009; nr. 611, datë 11.6.2009; nr. 677, datë 18.6.2009; nr. 706, datë 23.6.2009; nr. 805, datë 22.7.2009; nr. 1038, datë 14.10.2009; nr. 1134, datë 18.11.2009; nr. 1283, datë 23.12.2009; nr. 125, datë 17.2.2010; nr. 247, datë 13.4.2010; nr. 404, datë 26.5.2010; nr. 549, datë 7.7.2010; nr. 646, datë 28.7.2010; nr. 118, datë 17.2.2011; nr. 513, datë 1.8.2012; nr. 490, datë 18.6.2013; nr. 42, datë 21.1.2015; nr. 279, datë 1.4.2015; nr. 474, datë 3.6.2015; nr. 615, datë 7.7.2015, për miratimin e kalimit të pronësisë së disa parcelave ndërtimore, në favor të poseduesve të objekteve informale, të ndryshuara.....	2292
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 10.2.2016	Për një ndryshim në vendimin nr. 238, datë 23.3.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e Qendrës Historike të qytetit të Korçës dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj”.....	2297
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 110, datë 10.2.2016	Për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të z. Fadil Canaj.....	2297
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 3, datë 10.2.2016	Për formatin e aktit të konstatimit, procesverbalit të gjobës dhe aktit të konfiskimit të AMLF-së.....	2298
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 1248, datë 12.2.2016	Për delegim kompetence.....	2301
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetas Valbona Harizaj.....	2301



URDHËR
Nr. 10, datë 11.2.2016

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të nenit 27, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, dhe të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të institucionit, për Kuvendin e Shqipërisë, nëpunësit autorizues, Sekretarit të Përgjithshëm të këtij institucioni, znj. Albana Shtylla.

2. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor për Kuvendin e Shqipërisë:

2.1 Sekretarit të Përgjithshëm të këtij institucioni, znj. Albana Shtylla për procedurat e prokurimit, duke përjashtuar procedurat e parashikuara në pikën 2.2 të këtij urdhri;

2.2 Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Administrativ të këtij institucioni, znj. Etleva Zeqo, për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, si dhe procedurat e ceremonialit zyrtar sipas legjislacionit në fuqi;

2.3 Në mungesë të znj. Albana Shtylla apo në pamundësi të ushtrimit të kompetencave sipas pikës 2.1 të këtij urdhri, znj. Zeqo për nxjerrjen e akteve dhe kryerjen e procedurave të prokurimit të parashikuara në këtë pikë;

2.4 Në mungesë të znj. Etleva Zeqo apo në pamundësi të ushtrimit të kompetencave sipas pikës 2.2 të këtij urdhri, znj. Shtylla delegohet për nxjerrjen e akteve dhe kryerjen e procedurave të prokurimit të parashikuara në këtë pikë.

3. Kompetencat e deleguara të titullarit të Kuvendit të Shqipërisë, do të ushtrohen për periudhën, nga hyrja në fuqi e këtij urdhri deri në datën 31.12.2016.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm.

5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

6. Urdhri nr. 3, datë 15.1.2016 shfuqizohet.

KRYETARI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 91, datë 10.2.2016

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE
BAZË, TË SEKTORËVE QË DO TË
MBËSHTETEN DHE TË MASËS SË
PËRFITIMIT NGA FONDI I PROGRAMIT
PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN
RURAL, PËR VITIN 2016**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 6, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, dhe të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondi i miratuar në buxhetin e vitit 2016 për Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, zëri “Transferte në buxhetet familjare”, për mbështetjen e prodhimit bujqësor, blegtoral dhe të agropërpunimit, të përdoret për:

a) investimet për rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve për të garantuar furnizimin e qëndrueshëm të tregut;

b) përmirësimin e teknologjisë së kultivimit dhe të mbrojtjes së bimëve;

c) prodhimin e perimeve në ambiente të mbrojtura;

ç) mbarështimin e blegtorisë, bletarisë dhe akuakulturës;

d) furnizimin e qëndrueshëm të tregut dhe rritjen e të ardhurave financiare për familjet e zonave rurale;

dh) nxitjen e kreditimit bankar e të investimeve në sektorin e përpunimit, ruajtjes dhe marketingut të produkteve bujqësore, blegtorale, shpendëve, akuakulturës, mjaltit dhe bimëve medicinale;

e) rritjen e mundësisë së fermerëve për mjete të mekanizuara;



ë) nxitjen e formalizimit, kooperimit dhe organizimit të shoqërive të bashkëpunimit bujqësor (SHBB).

2. Masat e mbështetjes dhe masa e përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, sipas rajonizimit të hartës bujqësore, e cila miratohet me udhëzim të përbashkët të ministrit të Financave dhe ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, në shkallë vendi, të jenë, si më poshtë vijon:

a) Mbështetje për përmirësimin e teknologjisë të kultivimit dhe mbrojtjes së bimëve, si:

i) përmirësimi i teknologjisë së mbjelljes së vreshtave me fidanë të kultivarëve autoktonë, në vlerën 600 000 (gjashtëqind mijë) lekë/ha dhe me fidanë të kultivarëve të tjerë, në vlerën 500 000 (pesëqind mijë) lekë/ha;

ii) përmirësimi i teknologjisë së mbjelljes së mollëve, dardhëve, kumbullave, qershive, pjeshkëve, nektarinave, fiqve, ftonjve, shegëve, kivit, luleshtrydhes dhe agrumeve, në vlerën 200 000 (dyqind mijë) lekë/ha;

iii) përmirësimi i teknologjisë së mbjelljes së arrave, lajthive dhe bajameve, në vlerën 200 000 (dyqind mijë) lekë/ha për format intensive të kultivimit;

iv) përmirësimi i teknologjisë së mbjelljes dhe kultivimit të bimëve medicinale e aromatike të kultivuara, si: lavanda, timus, rigon, rozmarinë, mëllagë e bardhë, mëllagë e zezë, valeriane, mollë e egër, tërfili i kuq, lule dielli (për petale), kokoçeli (lule ciani) dhe shafra (Crocus sativus), në vlerën 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha;

v) mbështetja e fermave organike, në vlerën 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë/fermë të certifikuar;

vi) përmirësimi i teknikave të ujitjes nëpërmjet instalimit të ujitjes me pika në ullishte, vreshta, pemëtore, agrume, arvore dhe shegë (vetëm për format intensive të kultivimit të tyre), kundrejt faturës tatimore, por jo më shumë se 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha, por financimi të bëhet për jo më pak se 0,5 ha dhe jo më shumë se 10 ha;

vii) mbrojtja e ullishtave nga dëmtimi i mizës së ullirit në bllok dhe sipas zonave prioritare të prodhimit, me fond limit jo më shumë se 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë/ha, përfshirë TVSH-në;

viii) mbrojtja e pemëve frutore nga fatkeqësitë natyrore (nga breshëri), përmes vendosjes së rrjetave për mbrojtje nga breshëri, me fond limit jo

më shumë se 2 800 000 (dy milionë e tetëqind mijë) lekë/ha, përfshirë TVSH-në.

Sipërfaqja e mbjellë me kulturat e përshkruara sipas masave të përcaktuara në nënndarjet “i”–“iv”, të shkronjës “a”, të pikës 2, të këtij vendimi, duhet të jetë jo më e vogël se 0.2 ha dhe jo më e madhe se 10 ha.

b) Mbarështimi i blegtorisë, bletarisë dhe akuakulturës:

i) në vlerën 1 200 (një mijë e dyqind) lekë/krerë dele ose dhi të matrikulluara për fermat, të cilët mbarështojnë jo më pak se 100 krerë, por financimi të bëhet për jo më shumë se 300 krerë;

ii) në vlerën 1 000 (një mijë) lekë/koshere bletë për fermerët me jo më pak se 50, por jo më shumë se 300 (treqind) koshere blete;

iii) mbështetja e sektorit të akuakulturës, në masën 25% të vlerës së rasatit, por jo më shumë se 300 000 (treqind mijë) lekë/fermë dhe 25% të vlerës së ushqimeve për peshkun nën kultivim, por jo më shumë se 200 000 (dyqind mijë) lekë/fermë, vërtetuar me faturë tatimore.

c) Furnizimi i qëndrueshëm i tregut dhe rritja e të ardhurave financiare për familjet e zonave rurale, si:

i) mbështetja për dorëzimin e prodhimit të frutave dhe perimeve në pikat e grumbullimit ose përpunimit, në masën 15% të vlerës së mallit të shitur, të vërtetuar me faturë tatimore, përfshirë vlerën e tatimit. Sasia e dorëzimit të jetë për jo më pak se 100 kv dhe jo më shumë se 400 kv për frutat dhe perimet, si dhe për jo më shumë se 400 kv për fasulen pllaj;

ii) mbështetja në vlerën 10 (dhjetë) lekë/litrë qumësht për fermat blegtorale që mbarështojnë jo më pak se 10 (dhjetë) krerë lopë qumështi të matrikulluara, por financimi të bëhet për jo më shumë se 25 krerë dhe për jo më shumë se 2 000 litra për lopë. Pagesa të bëhet kundrejt sasive të qumështit, e vërtetuar me faturë tatimore;

iii) mbështetja e fermave blegtorale që mbarështojnë në mënyrë ekstensive (regjim gjysmëstallor) lopë të matrikulluara, në vlerën 5 000 (pesë mijë) lekë/krerë, por financimi të bëhet për jo më pak se 10 krerë dhe për jo më shumë se 20 (njëzet) krerë.

iv) mbështetja për dorëzimin e prodhimit të midhjeve në qendrat e grumbullimit dhe/të përpunimit, në vlerën 10 (dhjetë) lekë/kg, të dorëzuar (të shitur) e të vërtetuar me faturë



tatimore, por financimi të bëhet për jo më pak se 200 (dyqind) kv dhe jo më shumë se 1 000 (një mijë) kv në vit.

ç) Nxitja e investimeve dhe e kreditimit bankar në sektorin e bujqësisë, blegtorisë, shpendëve, bletarisë, akuakulturës dhe bimëve medicinale, si:

i) mbështetja, përmes subvencionit, në masën 70% të normës së interesit, për 7 (shtatë) vite radhazi, për kreditë deri në 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, që do të merren për aktivitetet e mëposhtme:

- ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore, blegtorale, akuakulturës, shpendëve dhe bimëve medicinale;

- mekanizimin e bujqësisë, blegtorisë, akuakulturës dhe bimëve medicinale;

- ndërtimin e objekteve që do të shërbejnë për mbarështimin e kafshëve, shpendëve e të akuakulturës;

- ndërtimin e serave për kultivimin e perimeve dhe prodhimin e fidanëve e të produkteve të tjera bujqësore.

ii) mbështetja e investimeve deri në 50% të vlerës së projektit, kundrejt faturës tatimore, përfshirë vlerën e tatimit, por jo më shumë se 20 000 000 (njëzet milionë) lekë për një subjekt, për:

- ngritje dhe/ose rikonstruksion ambientesh për grumbullim, përpunimin dhe ruajtje të produkteve bujqësore, blegtorale, produkteve të peshkimit e të akuakulturës, shpendëve dhe bimëve medicinale;

- ngritje dhe/ose rikonstruksion të ambienteve për mbarështim të kafshëve, shpendëve, peshkut dhe molusqeve;

- linja dhe/ose makineri dhe pajisje për standardizimin (paketim, mbushje, konservim, ambalazhim), tharje dhe/ose përpunim të prodhimeve bujqësore, blegtorale, mjalit, bimëve medicinale, shpendëve, produkteve të peshkimit e të akuakulturës, si dhe mjeteve të specializuara të transporti për sektorët e sipërpërmendur;

- makineri dhe pajisje për mekanizimin dhe modernizimin e proceseve të punës në komplekset blegtorale të shpendëve e të akuakulturës;

iii) ndërtimi i serave për kultivimin e perimeve, prodhimin e fidanëve dhe produkteve të tjera bujqësore, në masën 50% të vlerës së investimit, përfshirë vlerën e tatimit, por jo më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë për dynym, për sera me sipërfaqe minimumi 5 dynymë dhe jo më shumë se 2 ha;

iv) mbështetja e investimeve deri në masën 60% të vlerës për traktorë dhe/ose agregate të tjera bujqësore për manovrim në nivel ferme, përfshirë vlerën e tatimit.

3. Përfitues për masat e mbështetjes dhe masën e përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural do të jenë fermerë, personat fizikë, personat juridikë dhe shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor (SHBB).

4. Nga buxheti i miratuar i shpenzimeve operative të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural të përdoret fondi me vlerë limit prej 35 000 000 (tridhjetë e pesë milionë) lekësh, për aktivitete informuese për publikun lidhur me masat e mbështetjes nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2016.

5. Projektet e vlerësuara e të verifikuara ose të kontraktuara gjatë vitit 2015, të cilat janë shpallur fituese dhe nuk janë financuar plotësisht, për shkak të vonesave ligjore/administrative në përgatitjen e dokumentacionit përkatës nga autoritetet shtetërore (si lëshimi i lejes së ndërtimit dhe verifikimet e faturave nga autoriteti tatimor), të paguhen me fondet e vitit 2016, brenda tremujorit të parë të vitit 2016, por jo më shumë se fondi i alokuar prej 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekësh.

6. Nga fondi i përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, të përdoret shuma 280 000 000 (dyqind e tetëdhjetë milionë) lekë për bashkëfinancim me projektet IPA. Përdorimi i këtyre fondeve realizohet sipas marrëveshjes operationale të nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, AZHBR-së dhe GIZ-it.

7. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 99, datë 10.2.2016

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e



Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Adela Shera Karapici emërohet zëvendësministër i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 100, datë 10.2.2016

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Bahri Shaqiri emërohet zëvendësministër i Transportit dhe Infrastrukturës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 101, datë 10.2.2016

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Roni Telegrafi emërohet zëvendësministër i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 102, datë 10.2.2016

**PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË
PREFEKTIT TË QARKUT TË LEZHËS**

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 8927, datë 25.7.2002, “Për prefektin”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Eduard Ndreca emërohet prefekt i qarkut të Lezhës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 103, datë 10.2.2016

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË
MOBILIZIMIT TË PËRGJITHSHËM OSE
TË PJESSHËM TË BURIMEVE
NJERËZORE E MATERIALE TË VENDIT
GJATË PERIUDHËS PËR TË CILËN
KËRKOHET VENDOSJA E MASAVE TË
JASHTËZAKONSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “c”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të mobilizimit të përgjithshëm ose të pjesshëm të burimeve njerëzore e materiale të vendit gjatë periudhës për të cilën kërkohet vendosja e masave të jashtëzakonshme.

2. Mobilizimi ushtarak është detyrim ligjor i shtetasve për të siguruar plotësimin e njërive e të reparteve të strukturave ushtarake me personel gjatë periudhave në të cilat janë vendosur masa të jashtëzakonshme.

3. Mobilizimi kryhet në bazë të situatave të veçanta dhe nevojave të Forcave të Armatosura. Në rastet e mobilizimit të përgjithshëm ose të pjesshëm, thirren shtetasit sipas përcaktimit të bërë



në ligjin nr. 9047, datë 10.7.2003, “Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

4. Forcat rezervë, të cilat thirren gjatë mobilizimit të përgjithshëm ose të pjesshëm, janë pjesë e Forcave të Armatosura, të cilat janë të gatshme për pjesëmarrje gjatë gjendjeve në të cilat janë vendosur masa të jashtëzakonshme, si dhe për pjesëmarrje në misione/operacione në mbështetje të paqes, jashtë vendit.

5. Ministria e Mbrojtjes, për kapacitetet e domosdoshme të cilat nuk disponohen nga strukturat e saj apo të Forcave të Armatosura, mund të kontraktojë ose të marrë me qira mjete transporti, mjete xheniere dhe pajisje të tjera sipas nevojave. Angazhimi i tyre bëhet kundrejt pagesës së tarifave. Vlera e tarifave të zbatuara është ajo e përcaktuar nga vendimi përkatës i Këshillit të Ministrave për përcaktimin e tarifave për përdorim të përkohshëm nga organet shtetërore, në situatë emergjente, të çdo mjeti privat.

6. Ministria e Mbrojtjes, nëpërmjet Qendrës së Personel-Rekrutimit, harton listën e personelit rezervë që do të thirret gjatë gjendjeve në të cilat janë vendosur masa të jashtëzakonshme.

7. Lista emërore e personelit rezervë bëhet në bazë të nevojave të Forcave të Armatosura, sipas specialiteteve e funksioneve si dhe në bazë të organizimit të njërive të qeverisjes vendore.

8. Lista emërore e personelit në rezervë hartohet nga Qendra e Personel-Rekrutimit, në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, brenda muajit janar të çdo viti, e cila është jo më shumë se 25% e numrit të përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

9. Ministria e Mbrojtjes, nëpërmjet Qendrës së Personel-Rekrutimit, është përgjegjëse për mbajtjen dhe përditësimin e listës së personelit në rezervë që mund të aktivizohet gjatë gjendjeve në të cilat janë vendosur masa të jashtëzakonshme, në bazë të të dhënave që merr nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe njësitë e qeverisjes vendore.

10. Të gjithë ushtarakët në rezervë të Forcave të Armatosura detyrohen të raportojnë pranë Qendrës së Personel-Rekrutimit për ndryshimet e vendbanimit e të numrit të telefonit.

11. Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për transportin, është

përgjegjëse për mbajtjen dhe përditësimin e listës së mjeteve e të pajisjeve që do të aktivizohen gjatë gjendjeve në të cilat janë vendosur masa të jashtëzakonshme.

12. Ministria e Mbrojtjes identifikon dhe liston nevojat për mjete e pajisje, si dhe nënshkruan marrëveshje ose kontrata huaje me subjektet private dhe kontrata huapërdorjeje me subjektet publike pronare të tyre, ku përcaktohen detyrimet e palëve. Pronarët e mjeteve e të pajisjeve janë të detyruar të njoftojnë strukturat përkatëse në Ministrinë e Mbrojtjes për rastet e ndryshimit të pronësisë ose gatishmërisë së mjeteve e të pajisjeve të tyre.

13. Autoritetet e porteve e të aeroporteve kombëtare civile, nëpërmjet ministrisë përgjegjëse për transportin, deklarojnë në janar dhe në korrik të çdo viti kapacitetet e infrastrukturës së tyre në Ministrinë e Mbrojtjes, si dhe krijojnë të gjitha hapësirat e lehtësirat e nevojshme për trupat e huaja (personelin e pajisjet e tyre), të cilat vijnë në kuadrin e ndihmave për përballimin e gjendjeve në të cilat janë vendosur masa të jashtëzakonshme.

14. Autoritetet e porteve e të aeroporteve kombëtare, si dhe institucionet e tjera që shërbejnë si kapacitete kombëtare caktojnë pikat e kontaktit (personelin koordinator), të cilat ia raportojnë Ministrisë së Mbrojtjes për përballimin e gjendjeve në të cilat janë vendosur masa të jashtëzakonshme.

15. Qendra e Personel-Rekrutimit, prefektët dhe njësitë e qeverisjes vendore marrin masa për njoftimin e shtetasve dhe zbatimin e shpejtë të planit të mobilizimit.

16. Organet e njërive të qeverisjes vendore dhe Policia e Shtetit, për rastet e mobilizimit të përgjithshëm ose të pjesshëm, sigurojnë paraqitjen e shtetasve që thirren në bazë të listës emërore të personelit, të dërguar nga Qendra e Personel - Rekrutimit.

17. Trajtimi financiar, material apo me kompensime të tjera të shtetasve që thirren për rastet e mobilizimit të përgjithshëm ose të pjesshëm do të jetë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të trajtimit të ushtarakëve aktivë të Forcave të Armatosura.

18. Trajnimi i personelit rezervist për kryerjen e misioneve e të detyrave bëhet në bazë të strukturave në të cilat do të angazhohen, mbi bazë vjetore dhe sipas fondeve të caktuara për Ministrinë e Mbrojtjes, në përputhje me kërkesat e ligjit nr.



9047, datë 10.7.2003, “Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

19. Institucionet shëndetësore, private dhe publike, me kërkesë të Ministrisë së Mbrojtjes, mbajnë shtretër të lirë për trajtim mjekësor të personelit ushtarak pjesëmarrës në përballimin e gjendjeve në të cilat janë vendosur masa të jashtëzakonshme. Numri i shtretërve përcaktohet me marrëveshje mes Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Shëndetësisë.

Tarifat e rimbursimit për institucionet private caktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit të Shëndetësisë dhe ministrit të Mbrojtjes.

Rimbursimi i trajtimit mjekësor pranë institucioneve shëndetësore private të personelit ushtarak, pjesëmarrës në përballimin e gjendjeve në të cilat janë vendosur masa të jashtëzakonshme, përballohet rast pas rasti nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

20. Forcat e Armatosura krijojnë rezerva materiale për nevojat e veta dhe për mbështetjen e forcave rezerviste të cilat thirren gjatë mobilizimit të përgjithshëm ose të pjesshëm.

21. Në rastet e mobilizimit të përgjithshëm ose të pjesshëm Ministria e Mbrojtjes i kërkon ministrit përgjegjës për rezervat materiale të shtetit informacion për gjendjen e rezervave materiale të shtetit dhe lëvrimin e tyre, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9900, datë 10.4.2008, “Për rezervat material të shtetit”.

22. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 104, datë 10.2.2016

**PËR KALIMIN NË PRONËSI TË
BASHKISË BERAT, TË PASURISË ME NR.
2953, ME SIPËRFAQE 5 670 m², NË
ZONËN KADASTRALE 8505, BERAT,
DHE PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN
NR. 834, DATË 21.11.2012, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
LISTËS PËRFUNDIMTARE TË
PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,
QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE
NË PËRDORIM TË BASHKISË BERAT,
TË QARKUT TË BERATIT”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të Bashkisë Berat, të pasurisë me nr. 2953, me sipërfaqe 5 670 m², me vendndodhje në zonën kadastrale 8505, Berat, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, për t’u përdorur për zgjerimin e varrezave publike të qytetit të Beratit.

2. Prona e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, t’i shtohet listës së inventarit të pronave të paluajtshme, që i bashkëlidhet vendimit nr. 834, datë 21.11.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Berat, të qarkut të Beratit”, të ndryshuar.

3. Bashkisë Berat i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme, kryetari i Bashkisë Berat dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.



Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

2. FORMULARË PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE (Mbështetur në inventarin e pronave të veçanta të tipit infrastrukturë dhe shërbime publike)

Për një shtesë në listën përfundimtare të transferimit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 834, datë 21.11.2012

Bashkia/komuna: Berat

Fusha e përdorimit të pronës: Shërbime publike (varreza)

Nr. rend	A			B			C			
	Zona kadastrale dhe indeksi i hartës	Nr. i pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës Adresa	Sip. totale e pronës (m ²)	Nga sip. totale sa ndërtesë (m ²)	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
2953	8505 K-34-112-(240-A)	1260	Pyll	Pyll	5670		Shërbime publike	Bashkia Berat	Bashkia Berat	

VENDIM Nr. 106, datë 10.2.2016

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR FUNKSIONIMIN E ZONAVE TË TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8, të ligjit nr. 9789, datë 19.7.2007, “Për krijimin dhe funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendimi nr. 860, datë 10.10.2007, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullore së krijimit dhe të funksionimit të zonave ekonomike”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

RREGULLORE PËR FUNKSIONIMIN E ZONAVE TË TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe objektivat

1. Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave të funksionimit të zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, që i nënshtrohet dispozitave të ligjit nr. 9789, datë 19.4.2007, “Për krijimin dhe funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”, të ndryshuar.

2. Objektivat kryesorë të kësaj rregulloreje, janë:

a) përcaktimi i procedurave të funksionimit dhe mbikëqyrjes së zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik;

b) rregullimi i marrëdhënieve ndërmjet ministrisë përgjegjëse për ekonominë, zhvilluesit dhe institucioneve të tjera shtetërore që ndikojnë në zhvillimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik.

3. Në përputhje me qëllimin dhe objektivat, kjo rregullore përcakton:

a) organizimin e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik;

b) të drejtat dhe detyrimet e zhvilluesit;

c) procedurat e miratimit të përdoruesve dhe detyrimet e tyre;



ç) lejet e hyrjes;

d) lëvizjen e mallrave brenda dhe jashtë zonës;

dh) detyrat e përfaqësuesit të ministrisë përgjegjëse për ekonominë.

4. Për çdo çështje që nuk është subjekt i kësaj rregulloreje, zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi.

Neni 2

Përkufizime

Në kuptim të kësaj rregulloreje, me termat e mëposhtëm nënkuptohen:

1. “Zonë”, zona e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik.

2. “Ligj”, ligji nr. 9789, “Për krijimin dhe funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”, të ndryshuar.

3. “Zonë e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”, “zhvillues”, “përdorues”, kanë të njëjtin kuptim respektiv me atë të përcaktuar në ligj.

4. “Autoriteti doganor” dhe “detyrime doganore”, kanë të njëjtin kuptim respektiv me atë të përcaktuar në dispozitat e Kodit Doganor.

5. “Rregullore”, rregullorja për krijimin dhe funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik.

KREU II

ORGANIZIMI I ZONËS SË TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

Neni 3

Kufijtë e zonës

1. Kufijtë e zonës përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave për krijimin e zonës në fjalë.

2. Zona është e pajisur me të paktën dy porta hyrje-daljeje, nga të cilat njëra portë shërben për hyrjen dhe daljen e mallrave nga zona, ndërsa porta tjetër shërben për hyrjen dhe daljen e personave që punojnë në zonë.

Neni 4

Objektet infrastrukturore

1. Zhvilluesi ka për detyrë të realizojë, brenda afateve kohore të specifikuar në kontratën e lidhur me ministrinë përgjegjëse për ekonominë, të gjitha punimet e ndërtimit për ndërmarrjen e veprimtarive brenda zonës dhe të ofrojë infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me

infrastrukturën e jashtme. Zhvilluesi është përgjegjës për promovimin e zonës brenda dhe jashtë vendit.

2. Ndërtimi i objekteve infrastrukturore, si sistemi i kullimit, rrugët, telekomunikacioni, furnizimi me ujë të pijshëm, energji elektrike, sistemet e trajtimit të ujërave të zeza, ndërtimi i kufijve të zonës, magazinave, portat e hyrjes dhe të daljes dhe ndërtesa apo objekte të tjera realizohet nga zhvilluesi.

Neni 5

Infrastruktura e jashtme

Ministria përgjegjëse për ekonominë në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për infrastrukturën, mjedisin dhe tokën harton dhe planifikon fondet e duhura për të siguruar infrastrukturën e nevojshme deri në kufijtë e zonës.

Neni 6

Siguria e ndërtesave dhe objekteve nga zhvilluesi dhe përdoruesi

1. Zhvilluesi është përgjegjës për sigurinë e ndërtesave, objekteve infrastrukturore dhe të kufijve të zonës dhe mbikëqyr ndryshimet që ndodhin në zonë. Zhvilluesi sigurohet që hapësirat, objektet dhe ndërtesat e dhëna me qira mbahen, ruhen dhe dorëzohen nga përdoruesit në kushte të mira, për të mos penguar vazhdimin e veprimtarive në zonë. Kur shihet e nevojshme, zhvilluesi merr masat që përdoruesit të mbulojnë shpenzimet për restaurimin e objekteve apo ndërtesave të dëmtuara prej tyre dhe kthimin e tyre në gjendjen fillestare.

2. Zhvilluesi merr masat që zona të pajiset me kapacitetet dhe infrastrukturën e nevojshme për t’iu përgjigjur situatave emergjente në zonë, të tilla si: shpërthime zjarri, dëmtime të tubacioneve, rrjedhje apo ndotje toksike.

3. Përdoruesit, brenda ambienteve të tyre, marrin të gjitha masat për të parandaluar situatat emergjente dhe aksidentet në punë dhe për të siguruar ndihmën e parë, detyrime të cilat do të jenë objekt i aktmarrëveshjes.

4. Përdoruesit mbajnë përgjegjësi për dëmet që iu shkaktohen zhvilluesit dhe përdoruesve të tjerë nga aktivitetet që lidhen me veprimtarinë e tyre, përgjegjësi të cilat do të jenë objekt i aktmarrëveshjes.



Neni 7

Fushat e veprimtarisë në zonë

Në zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik lejohet zhvillimi i veprimtarive të parashikuara në ligj dhe në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave për krijimin e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik.

Neni 8

Aplikimi për licencë zhvilluesi

1. Zhvilluesi aplikon për licencë zhvilluesi në zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, pranë ministrisë përgjegjëse për ekonominë.

2. Kërkesa duhet të bëhet me shkrim dhe të shoqërohet me kontratën e lidhur ndërmjet ministrisë përgjegjëse për ekonominë dhe zhvilluesit të zonës.

Neni 9

Përmbajtja e licencës

Forma dhe përmbajtja e licencës së zhvilluesit miratohet nga ministri përgjegjës për ekonominë.

1. Licenca duhet të përmbajë:

a) numrin e regjistrimit;

b) emrin e zhvilluesit;

c) kufijtë e zonës;

ç) aktivitetet kryesore që do të zhvillohen në zonë;

d) datën e lëshimit;

dh) kohëzgjatjen e licencës.

2. Licenca nënshkruhet nga ministri përgjegjës për ekonominë.

3. Licenca shoqërohet me kontratën e lidhur ndërmjet ministrisë përgjegjëse për ekonominë dhe zhvilluesit, në të cilën specifikohen kushtet që duhet të plotësojnë palët respektive.

4. Licenca hartohet në tri kopje dhe regjistrohet në regjistrin e licencave për zhvilluesit në zonat e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, që mbahet në ministrinë përgjegjëse për ekonominë.

5. Pagesa e zhvilluesit për marrjen e licencës të jetë 500 000 (pesëqind mijë) lekë dhe të ardhurat e siguruara të trajtohen si të ardhura publike duke u derdhur tërësisht në buxhetin e shtetit.

Neni 10

Regjistri i licencave për zhvilluesit dhe përdoruesit në zonat e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik

1. Çdo person juridik, i cili ushtron veprimtarinë si zhvillues i zonës, regjistrohet në regjistrin që mbahet në ministrinë përgjegjëse për ekonominë. Regjistri përmban informacion të saktë dhe të detajuar mbi llojin e licencës, emërtimin e zhvilluesit, llojin e aktivitetit, kohën e funksionimit.

2. Çdo person fizik dhe juridik, i cili ushtron veprimtarinë si përdorues në zonë regjistrohet në regjistrin që mbahet në ministrinë përgjegjëse për ekonominë. Regjistri përmban informacion të saktë dhe të detajuar në lidhje me:

a) kërkesën për miratimin si përdorues;

b) miratimin apo refuzimin përfundimtar të kërkesës;

c) llojin e aktivitetit;

ç) çdo vendim të zhvilluesit për pezullimin e përkohshëm të aktivitetit të përdoruesit;

d) çdo vendim të zhvilluesit të zonës për të cilën ka marrë miratimin e ministrisë përgjegjëse për ekonominë për revokimin e akt marrëveshjes me përdoruesin;

dh) çdo vendim të ministrisë përgjegjëse për ekonominë për revokimin e menjëhershëm të miratimit të aktmarrëveshjes;

e) çdo vendim administrativ apo gjyqësor të nxjerrë për ankimet ndaj vendimeve të parashikuara në shkronjat “ç” deri në “dh” të kësaj pike.

Neni 11

Kushtet e punës

1. Zhvilluesi dhe përdoruesit me aktivitet në zonë dhe punonjësit e tyre i nënshtrohen Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë.

2. Dispozitat ligjore që rregullojnë pagën minimale mujore dhe pagën për orë shtesë në punë zbatohen për zhvilluesin dhe përdoruesit në zonë.

3. Kontratat e punës midis punëdhënësit dhe punëmarrësit nënshkruhen në tri kopje, ku një kopje depozitohet në ministrinë përgjegjëse për ekonominë.

4. Zhvilluesit dhe përdoruesit kanë detyrimin që të sigurojnë kushte pune të sigurta dhe të shëndetshme për punonjësit e tyre.



Neni 12

Leje pune për shtetasit e huaj

1. Zhvilluesit dhe përdoruesit dorëzojnë në institucionet përgjegjëse kërkesën për të pajisur me leje pune punonjësit me shtetësi të huaj që planifikojnë të punësojnë në zonë. Ministria përgjegjëse për ekonominë, me kërkesë të zhvilluesit ose përdoruesit, asiston me procedurën e aplikimit për lejet përkatëse.

2. Përdoruesit janë përgjegjës për veprimet dhe sjelljen e punonjësve të tyre brenda zonës dhe për çdo dëm të shkaktuar prej tyre mbi të tretë apo ndaj zonës dhe objekteve brenda saj, gjatë kryerjes së punës.

Neni 13

Orari i punës dhe mbikëqyrja e hyrjeve në zonë

1. Zhvilluesi është i detyruar të ketë të gatshëm personelin e nevojshëm në zonë për të siguruar funksionimin e saj.

2. Personat, që kërkojnë të hyjnë në zonë, duhet të paraqesin lejen e hyrjes, kartën e shërbimit apo lejen e posaçme të hyrjes të punonjësi i sigurisë dhe/ose përfaqësuesi i autoritetit doganor. Personat të cilët nuk paraqesin cilindo prej këtyre dokumenteve nuk do të lejohen të hyjnë në zonë.

3. Përfaqësuesit e autoritetit doganor kanë të drejtën të kontrollojnë mjetet dhe personat në mënyrë që të shmanget dalja e mallrave nga zona pa iu nënshtruar procedurave doganore. Ambientet e punës dhe mjetet e përdoruesve mund të jenë, gjithashtu, objekt i kontroleve nga përfaqësuesit e autoritetit doganor të zonës me kërkesë të zhvilluesit.

KREU III

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ZHVILLUESIT

Neni 14

Të drejtat e zhvilluesit

Zhvilluesi ka të gjitha të drejtat e parashikuara në ligj, në aktet e tjera nënligjore që rrjedhin prej tij dhe në kontratat që ka lidhur me persona të tjerë për veprimtarinë në zonë.

Neni 15

Detymimet e zhvilluesit

Përveç detyrimeve të parashikuara në ligj dhe në aktet e tjera nënligjore dhe detyrimeve të

përcaktuara në kontratë, zhvilluesi duhet të plotësojë edhe detyrimet e mëposhtme:

1. Detyrimet e zhvilluesit në lidhje me ndërtimet në zonë, si:

a) ngritja e kufijve rrethues, sipas perimetrit të zonës, për të realizuar sigurimin dhe veçimin fizik të këtij territori;

b) ndërtimi i portave të hyrjes dhe të daljes nga zona;

c) ndërtimi i shesheve, objekteve dhe mjediseve brenda zonës së nevojshme për kontrollin e lëvizjen e mallrave, njerëzve e të mjeteve të transportit;

ç) ndërtimi i zyrave për përfaqësuesit e ministrisë përgjegjëse të ekonomisë, autoriteteve doganore dhe për punonjësit e rendit, të cilat u jepen atyre në përdorim pa shpërbllim;

d) ndërtimi i infrastrukturës brenda zonës dhe lidhja e saj me infrastrukturën jashtë zonës bëhen duke ndjekur të gjitha rrugët në zbatim të legjislacionit në fuqi për planifikimin e territorit;

dh) siguri i mirëmbajtjes së infrastrukturës dhe godinave të përmendura në shkronjën “d” dhe siguri i të gjitha kushteve normale të përdorimit të tyre;

e) detyrimi i zhvilluesit për të ngritur sisteme videomonitorimi dhe e drejta e aksesit në to i autoriteteve doganore për të ushtruar kontroll, veçanërisht për hyrje daljet.

2. Detyrimet e zhvilluesit në marrëdhëniet me organet shtetërore, janë:

a) Zhvilluesi ka të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Kodi Doganor. Ai duhet të lejojë autoritetet doganore për të kryer kontrollet e nevojshme brenda zonës, duhet të jetë i gatshëm të paraqesë, sa herë që kërkohen nga autoritetet doganore, të gjitha dokumentet që ai disponon dhe të japë ndihmën e nevojshme për ekzaminimin fizik e dokumentar të mallrave në pronësi të përdoruesve;

b) Zhvilluesi duhet t'i japë përfaqësuesit të ministrisë përgjegjëse për ekonominë të dhënat dhe dokumentacionin e nevojshëm lidhur me aktivitetin që kryhet në zonë, të kërkuar nga kjo ministri;

c) Zhvilluesi duhet të lejojë ushtrimin e funksioneve të organeve të rendit dhe të të gjitha institucioneve e të organeve të tjera të kontrollit shtetëror në zonë;

ç) Zhvilluesi ka për detyrë të bashkëpunojë me përfaqësuesit e ministrisë përgjegjëse për ekonominë për të lëshuar të gjitha lejet e hyrjes.



KREU IV
PROCEDURA E MIRATIMIT DHE
DETYRIMET E PËRDORUESVE NË
ZONËN E TEKNOLOGJISË DHE
ZHVILLIMIT EKONOMIK

Neni 16

Miratimi i përdoruesit

1. Çdo person fizik ose juridik, shqiptar ose i huaj, pasi ka lidhur një aktmarrëveshje paraprake me zhvilluesin, paraqet pranë ministrisë përgjegjëse për ekonominë kërkesën për të marrë miratimin si përdorues.

2. Ministria përgjegjëse për ekonominë, brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për përdorues, merr në shqyrtim kërkesën dhe vendos të miratojë ose jo përdoruesin e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik.

3. Bashkëlidhur kërkesës për miratimin e përdoruesit, kandidati për përdorues duhet të paraqesë nga dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Aktmarrëveshjen ndërmjet zhvilluesit dhe kandidatit për përdorues;

b) Planbiznesin e hollësishëm në lidhje me aktivitetin që do të kryhet, ku të përshkruhen qartë plani i punësimit, plani i investimeve dhe treguesit që do të realizohen, duke mbajtur parasysh nxitjen e industrive të reja, teknologjive novatore, industrive që plotësojnë standardet ndërkombëtare për eliminimin e ndotjes, industrive eficiente në përdorimin e energjisë, si dhe industrive me produktivitet të lartë, në raport me punonjësit, me kusht që të mos ketë efekt dëmtesues material në veprimtaritë ekonomike në tregun vendas.

4. Kur kandidati për përdorues është person fizik ose juridik i regjistruar dhe/ose ka ushtruar aktivitet jashtë zonës duhet të dorëzojë:

a) Ekstraktin e regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit, si dhe ekstraktin për historikun e subjektit;

b) Vërtetimin nga dega e tatimeve që subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore;

c) Vërtetime nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin;

ç) Vërtetimin që nuk është në proces falimentimi dhe kapitalet e tij janë në proces ekzekutimi nga përmbaruesit.

Kandidati/ofertuesi i huaj duhet të vërtetojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër.

Nëse dokumentet e sipërpërmendura nuk lëshohen në shtetin e origjinës, atëherë mjafton një deklaratë me shkrim nga ana e kandidatit/ofertuesit.

Neni 17

Pezullimi i përkohshëm i veprimtarisë

1. Zhvilluesi ka të drejtën të pezullojë përkohësisht aktivitetin e përdoruesit, kur:

a) përdoruesi, një përfaqësuesi i tij i autorizuar apo punonjësit e tij dëmtojnë mjediset, objektet, pajisjet apo ndërtesat e zonës dhe vazhdojnë të kryejnë këtë veprim pavarësisht nga marrja e njoftimit nga ana e zhvilluesit për të ndaluar dhe/ose mospagesa e dëmshpërblimit;

b) përdoruesi nuk vepron në përputhje me kushtet e kontratës së lidhur me zhvilluesin;

c) moszbatimi i udhëzimeve të shkruara apo sjellja në mënyrë të atillë që cenon rendin në zonë;

ç) mosdeklarimi i ndryshimeve nga përdoruesi lidhur me angazhimet e vendosura në kontratën e lidhur midis zhvilluesit dhe përdoruesit;

d) zhvilluesi për çdo rast pezullimi të përkohshëm të aktivitetit të përdoruesit njofton ministrinë përgjegjëse për ekonominë.

2. Zhvilluesi me miratimin e ministrisë përgjegjëse për ekonominë vendos të revokojë aktmarrëveshjen e lidhur ndërmjet zhvilluesit dhe përdoruesit nëse:

a) nga raportet periodike të zhvilluesit vërehet se në përfundim të afateve kohore, sipas pikës 1, të këtij neni, veprimet që shkaktuan pezullimin janë ende në vazhdim;

b) konfirmohet nëpërmjet kontrollove dhe inspektimeve të mëtejshme që angazhimet dhe deklaratimet e përdoruesit të vendosura në kontratën e lidhur me zhvilluesin nuk janë përmbushur apo rezultojnë të pavërteta;

c) rezulton se janë shkelur dispozitat e ligjit dhe apo të rregullores.

3. Ministria përgjegjëse për ekonominë vendos për revokimin e menjëhershëm të miratimit të aktmarrëveshjes ndërmjet zhvilluesit dhe përdoruesit, brenda zonës kur vërtetohet se:

a) përdoruesi ka kryer evazion fiskal duke deklaruar të ardhurat e krijuara nga veprimtaritë jashtë zonës si të ardhura të fituara në zonë ose duke paraqitur informacion të rremë/mashtues për këtë qëllim;



b) mallrat kanë dalë nga zona në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe kur ka mospërputhje midis inventarit të mallrave brenda në zonë dhe të dhënave në regjistrin e stokut aktual;

c) përdoruesi gjatë zhvillimit të aktivitetit të tij nuk ka zbatuar për punonjësit legjislacionin në fuqi për punën.

Neni 18

Afatet e kontratës

Të gjitha kontratat që lidhen ndërmjet zhvilluesit dhe përdoruesit kanë një afat jo me të gjatë sesa afati i kontratës të lidhur ndërmjet zhvilluesit dhe institucionit përgjegjës, por jo më shumë se afati i licencës së zhvilluesit.

Neni 19

Ndryshimet dhe rinovimi i kontratës

Çdo përdorues ka të drejtë të kërkojë ndryshimin ose rinovimin e kontratës me zhvilluesin, duke ndjekur procedurën e përcaktuar në nenin 16 të kësaj rregulloreje.

Neni 20

Licencimi i përdoruesit

Për ushtrimin e veprimtarive dhe përdorimin e të mirave publike, për të cilat kërkohet pajisja me një leje ose licencë, përdoruesi aplikon pranë institucioneve përgjegjëse për lëshimin e licencave e të lejeve dhe pajiset me to në zbatim të legjislacionit në fuqi për licencimin dhe lejet.

Neni 21

Detyrimet e përdoruesit

Gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tij në zonë, përdoruesi ka këto detyrime:

a) Të lejojë ushtrimin e kontrollit nga autoritetet doganore dhe tatimore mbi veprimtarinë e tij në zonë;

b) Të lejojë organet e rendit dhe të gjitha organet e tjera të kontrollit shtetëror të ushtrojnë funksionet e tyre në zonë;

c) Të vërë në dispozicion të përfaqësuesit të ministrisë përgjegjëse për ekonominë të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me veprimtarinë e tij në zonë;

ç) Të zbatojë të gjitha detyrimet e parashikuara në kontratën e lidhur me zhvilluesin.

KREU V

DOKUMENTET E HYRJES NË ZONËN E TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

Neni 22

Lëshimi i lejeve të hyrjes

1. Lejet e hyrjes dhe lejet e posaçme përgatiten nga zhvilluesi për të gjithë personat që hyjnë në zonë. Lejet siglohen nga përfaqësuesi i ministrisë përgjegjëse për ekonominë dhe nëpunësi i autoritetit doganor.

2. Procedura e pajisjes me leje kryhet, si më poshtë vijon:

a) Pajisen me leje hyrje të gjithë punonjësit që punojnë për zhvilluesin dhe përdoruesin në zonë, si dhe nëpunësit shtetërorë të ministrisë përgjegjëse për ekonominë, nëpunësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe punonjësit e rendit që janë të ngarkuar të monitorojnë zonën;

b) Pajisen me leje të posaçme të gjithë ata persona që hyjnë në zonë për detyra të përkohshme ose për të bashkëpunuar përkohësisht me autoritetet shtetërore, apo me zhvilluesin dhe përdoruesin.

3. Ndalohet hyrja në zonë e personave që nuk janë të pajisur me lejet përkatëse.

Neni 23

Përmbajtja dhe kohëzgjatja e lejeve

1. Leja e hyrjes është njëvjeçare dhe përmban:

a) emrin dhe mbiemrin e zotëruesit të lejes;

b) emrin e shoqërisë me të cilën ai është në marrëdhënie pune brenda zonës;

c) profesionin;

ç) shtetësinë;

d) numrin dhe serinë e dokumentit të identifikimit;

dh) fotografinë;

e) afatin e përdorimit të lejes;

ë) firmën e përfaqësuesit të ministrisë përgjegjëse për ekonominë, të përfaqësuesit të doganës, të rendit.

2. Leja e posaçme lëshohet në këmbim të një dokumenti identifikimi dhe është me kohëzgjatje jo më shumë se tridhjetë ditë pune. Kjo leje përmban:

a) numrin e serisë;

b) emrin e personit që do të hyjë në zonë;



- c) destinacionin brenda zonës;
- ç) kohën e lëshimit;
- d) firmën e punonjësit që e lëshon.

3. Për sa u përket mjeteve të transportit rrugor, hekurudhor dhe detar, hyrja e tyre në zonën bëhet me leje të posaçme e duke zbatuar rregullat e parashikuara në Kodin Doganor për mjetet e transportit.

Neni 24

Anulimi dhe zëvendësimi i lejeve të hyrjes

1. Leja e hyrjes anulohet në rastet kur zotëruesi i saj ndërpret marrëdhëniet e punës me zhvilluesin ose përdoruesin. Në këto raste zhvilluesi duhet të informojë përfaqësuesin e ministrisë përgjegjëse për ekonominë për anulimin e lejes.

2. Zhvilluesi ka të drejtë të largojë nga zona çdo person, të cilit i është anuluar leja e hyrjes. Në këto raste nëpunësit e autoritetit doganor duhet të zbatojnë rregulloren e doganës për mallrat që zotëron personi.

3. Leja e hyrjes mund të zëvendësohet vetëm në rastet kur ajo humbet ose dëmtohet në mënyrë të paqëllimshme. Zotëruesi pajiset me dublikatë jo më vonë se 5 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës.

4. Ngarkohet zhvilluesi të kontrollojë lejet e hyrjes në zonë për të gjithë zotëruesit e tyre.

KREU VI

QARKULLIMI I MALLRAVE BRENDA DHE JASHTË ZONËS SË TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

Neni 25

Mallrat e ndaluara dhe mallrat për të cilat kërkohen masa apo ndërtesa të posaçme

1. Në zonë ndalohet hyrja e lëndëve radioaktive, mbetjeve të rrezikshme e toksike dhe armëve të zjarrit e të municioneve. Përjashtim bëjnë nëpunësit e rendit të ngarkuar me ruajtjen e zonës dhe organet shtetërore të cilëve u lejohej mbajtja e armëve dhe municioneve kur këto i kanë me leje nga organet kompetente për lëshimin e saj.

2. Kur lëndët plasëse, flakënxitëse, djegëse, eksplozivët, lëndët narkotike, psikotrope, lëndë të tjera kimike apo materiale të rrezikshme vendosen bashkë me lëndë të tjera, do të lejohen

të hyjnë në zonë me kusht që të përdoren vetëm për qëllime industriale e për përmbushjen e masave të posaçme apo për ndërtimin e një godine të përshtatshme për vendosjen e tyre, si dhe marrjen e licencës përkatëse.

3. Hyrja dhe dalja nga zona e lëndëve të sipërpërmendura bëhet me miratimin e ministrive të linjës dhe i nënshtrohet dispozitave ligjore përkatëse, kombëtare dhe ndërkombëtare.

Neni 26

Mallrat dhe mbetjet për nxjerrje dhe asgjësim

1. Mënyra e menaxhimit dhe asgjësimit të mbetjeve do të bëhet në zbatim të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

2. Asgjësimi i mbetjeve që klasifikohen të rrezikshme, sipas nenit 15, të rregullores, i nënshtrohet dispozitave ligjore përkatëse, kombëtare dhe ndërkombëtare.

Neni 27

Mallrat e braktisura dhe mallrat e shpërndara

1. Mallrat e braktisura në mjedise, që nuk i përkasin asnjë përdoruesi, grumbullohen nga zhvilluesi nën mbikëqyrjen e autoritetit doganor dhe të dhënat e tyre hidhen në regjistrin përkatës. Zhvilluesi i nxjerr në ankand këto mallra sipas dispozitave ligjore në fuqi.

2. Mallrat e shpërndara gjatë ngarkimit, shkarkimit, transportit apo veprimeve të tjera u rikthehen pronarëve përkatës nga zhvilluesi me kusht që kostot e grumbullimit, pastrimit dhe ripaketimit të mbulohen nga përdoruesi. Në rast të kundërt, ato do të cilësohen si mallra të braktisura.

KREU VII

DETYRAT E PËRFAQËSUESIT TË MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR EKONOMINË

Neni 28

Detyrat e përfaqësuesve të ministrisë përgjegjëse për ekonominë

Ministria përgjegjëse për ekonominë ka detyrë të kontrollojë dhe të mbikëqyrë në mënyrë të vazhdueshme funksionimin e zonës. Detyrat e përfaqësuesit të ministrisë janë, si më poshtë vijon:



1. Të mbikëqyrë dhe të kontrollojë aktivitetin e zhvilluesve, në përputhje me kushtet e përcaktuara në aktmarrëveshjen që lidhet midis ministrisë përgjegjëse për ekonominë dhe zhvilluesit.

2. Të mbikëqyrë dhe të kontrollojë aktivitetin e përdoruesve, në përputhje me kushtet e përcaktuara në aktmarrëveshjen e lidhur me zhvilluesin dhe miratimin e ministrisë përgjegjëse për ekonominë.

3. Për çdo shkelje të konstatuar, të procedojë për vendosjen e gjobave deri në propozimin për heqjen e licencës. Masat administrative përcaktohen në aktmarrëveshjen e lidhur midis ministrisë përgjegjëse për ekonominë dhe zhvilluesit.

4. Të miratojë lejet e hyrjes dhe lejet posaçme, të lëshuara nga zhvilluesi duke i sigluar.

Neni 29

Kontrolli nga institucionet e tjera shtetërore

1. Institucionet e tjera shtetërore mund të kontrollojnë punimet për ndërtimin e zonës nga zhvilluesi ose aktivitetin e përdoruesit, të cilat, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, janë përgjegjëse për realizimin e tyre.

2. Zhvilluesi ka si detyrim t'i paraqesë institucionit përgjegjës të gjitha raportet dhe certifikatat e lëshuara nga institucionet e tjera shtetërore, në lidhje me kontrollet e ushtruara në zonë zhvilluesit dhe përdoruesit.

VENDIM

Nr. 107, datë 10.2.2016

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 538, DATË 26.5.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR LICENCAT DHE LEJET, QË TRAJTOHEN NGA APO NËPËRMJET QENDRËS KOMBËTARE TË LICENCIMIT (QKL) DHE DISA RREGULLIME TË TJERA NËNLIGJORE TË PËRBASHKËTA”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 15 e 36, të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 2/1, të ligjit nr. 9573, datë 3.7.2006, “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë

përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe të ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në aneksin 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, fusha VII “Transporti”, kategoria VII.3 “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale të lidhura me transportin rrugor”, pas pikës 7 shtohet nënkategoria VII.3.B “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, me këtë përmbajtje:

“1. Kategoria “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale të lidhura me transportin rrugor”, me kodin VII.3, përfshin licencën e nënkategorisë VII.3.B “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”.

2. Veprimtaritë e nënkategorisë VII.3.B specifikohen në:

2.1 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, me kodin VII.3.B.1, ku përfshihen:

a) riparimi dhe mirëmbajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

b) riparimi dhe mirëmbajtja e karrocërisë së mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

c) riparimi dhe mirëmbajtja e impiantit elektrik të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

ç) riparimi dhe mirëmbajtja e gomave të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

d) blerja, shitja e mjeteve me motor dhe rimorkiove;

dh) mbledhja, depozitimi, shkatërrimi i mjeteve ose pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit apo të braktisura.

2.2 “Shitblerja e mjeteve rrugore me motor dhe/ose e rimorkiove të reja ose të përdorura”, me kodin VII.3.B.2, ku përfshihet shitblerja e



mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre, të reja dhe/ose të përdorura, të autorizuar nga prodhuesi.

2.3 “Tregtimi i pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe/ose të rimorkiove”, me kodin VII.3.B.3, ku përfshihen:

a) tregtimi i pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe/ose të rimorkiove;

b) tregtimi i pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe/ose të rimorkiove, të autorizuar nga prodhuesi.

2.4 “Agjenci që trajtojnë praktikat e qarkullimit të mjeteve me motor dhe/ose të rimorkiove”, me kodin VII.3.B.4.

3. Licenca për veprimtaritë me kodin VII.3.B jepet për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit.

4. Kriteret e posaçme të licencimit dhe llojet e dokumenteve provuese e shoqëruese për specifikimet me kodet VII.3.B.1 dhe VII.3.B.2 jepen në tabelën 1 më poshtë:

Tabela 1

Kriteret e posaçme	Mbi çfarë faktorësh veprimtarie dhe/ose specifikash e specialitetesh aplikohen kriteret e posaçme	Llojet e dokumenteve provuese lidhur me kriteret e posaçme
Përshtatshmëria e njohurive dhe eksperiencës së personelit	Drejtuksi teknik i përgjithshëm (sipas specifikimeve)	a) Certifikatë për drejtuesin teknik të përgjithshëm b) Akte që provojnë marrëdhëniet e kërkuara të punës
Përshtatshmëria e pajisjeve, teknologjisë dhe mjediseve me standardet e shërbimit	a) Mjediset b) Pajisjet	Sipas rastit: dokumente pronësie dhe /ose përdorimi, si dhe /ose dokumente që pasqyrojnë cilësitë e garancitë e këtyre faktorëve
Përshtatshmëria e organizimit dhe rregullave të funksionimit	Rregullat e brendshme të përgjithshme	Rregullore të brendshme të funksionimit
Besueshmëria financiare	Një sasi kapitali minimale dhe rezervë	Dokument që vërteton kënaqjen e këtij kriteri

5. Kriteret e posaçme të licencimit, si dhe llojet e dokumenteve provuese e shoqëruese për specifikimet me kodet VII.3.B.3 dhe VII.3.B.4 jepen në tabelën 2 më poshtë:

Tabela 2

Kriteret e posaçme	Mbi çfarë faktorësh veprimtarie dhe/ose specifikash e specialitetesh aplikohen kriteret e posaçme	Llojet e dokumenteve provuese lidhur me kriteret e posaçme
Përshtatshmëria e njohurive dhe eksperiencës së personelit	Drejtuksi teknik i përgjithshëm (sipas specifikimeve)	a) Certifikatë për drejtuesin teknik të përgjithshëm b) Akte që provojnë marrëdhëniet e kërkuara të punës
Përshtatshmëria e pajisjeve, teknologjisë dhe mjediseve me standardet e shërbimit	a) Mjediset b) Pajisjet	Sipas rastit: dokumente pronësie dhe/ose përdorimi, si dhe/ose dokumente që pasqyrojnë cilësitë e garancitë e këtyre faktorëve
Përshtatshmëria e organizimit dhe rregullave të funksionimit	Rregullat e brendshme të përgjithshme	Rregullore të brendshme të funksionimit

6. Licencimi i nënkategorisë B të veprimtarisë bëhet sipas grupit III.

7. Institucioni tjetër lidhur me këtë licencim është Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës.

8. Vendimi bazohet vetëm në dokumentet provuese të licencimit.

9. Afati i marrjes së këtij vendimi është 15 ditë.

10. Licenca për veprimtarinë e nënkategorisë VII.3.B ka afat 5-vjeçar.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 108, datë 10.2.2016**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMET
E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.
1657, DATË 24.12.2008; NR. 100, DATË
27.1.2009; NR. 286, DATË 18.3.2009; NR.
450, DATË 6.5.2009; NR. 611, DATË
11.6.2009; NR. 677, DATË 18.6.2009; NR.
706, DATË 23.6.2009; NR. 805, DATË
22.7.2009; NR. 1038, DATË 14.10.2009; NR.
1134, DATË 18.11.2009; NR. 1283, DATË
23.12.2009; NR. 125, DATË 17.2.2010; NR.
247, DATË 13.4.2010; NR. 404, DATË
26.5.2010; NR. 549, DATË 7.7.2010; NR. 646,
DATË 28.7.2010; NR. 118, DATË 17.2.2011;
NR. 513, DATË 1.8.2012; NR. 490, DATË
18.6.2013; NR. 42, DATË 21.1.2015; NR. 279,
DATË 1.4.2015; NR. 474, DATË 3.6.2015;
NR. 615, DATË 7.7.2015, PËR MIRATIMIN
E KALIMIT TË PRONËSISË SË DISA
PARCELAVE NDËRTIMORE, NË
FAVOR TË POSEDUESVE TË
OBJEKTEVE INFORMALE, TË
NDRYSHUARA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, të shkronjës “ç”, të nenit 4, të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995, “Për shitblerjen e trojeve”, të ndryshuar, dhe të nenit 163, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 1657, datë 24.12.2008; nr. 100, datë 27.1.2009; nr. 286, datë 18.3.2009; nr. 450, datë 6.5.2009; nr. 611, datë 11.6.2009; nr. 677, datë 18.6.2009; nr. 706, datë 23.6.2009; nr. 805, datë 22.7.2009; nr. 1038, datë 14.10.2009; nr. 1134, datë 18.11.2009; nr. 1283, datë 23.12.2009; nr. 125, datë 17.2.2010; nr. 247, datë 13.4.2010; nr. 404, datë 26.5.2010; nr. 549, datë 7.7.2010; nr. 646, datë 28.7.2010; nr. 118, datë 17.2.2011; nr. 513, datë 1.8.2012; nr. 490, datë 18.6.2013; nr. 42, datë 21.1.2015; nr. 279, datë 1.4.2015; nr. 474, datë

3.6.2015; nr. 615, datë 7.7.2015, të ndryshuara, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 157/239, 10/382, 10/357, 10/360, 10/342, 10/344, 10/323, 10/341, 10/365, 10/355, 10/334 e 1455/134 në drejtoritë e ALUIZNI-t Durrës, Shkodër dhe Tërana 5, janë sipas lidhjes B, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelën ndërtimore me nr. pasurie 303/35 në Drejtorinë e ALUIZNI-t Elbasan janë sipas lidhjes C, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelën ndërtimore me nr. pasurie 3/153 në Drejtorinë e ALUIZNI-t Elbasan, janë sipas lidhjes E, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 4/257, 8511, 4/415 e 112/11 në drejtoritë e ALUIZNI-t Elbasan, Durrës dhe Tërana 1, janë sipas lidhjes F, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 7/590, 2/502 e 2/499 në Drejtorinë e ALUIZNI-t Tërana 1, janë sipas lidhjes G, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 3/191, 3/189, 8/904, 8/1265, 6/248, 14/170, 13/187, 13/188, 7/119, 25/135 e 24/193 në drejtoritë e ALUIZNI-t Tërana 1 dhe Elbasan, janë sipas lidhjes H, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

7. Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 400/454, 4/569, 2/515, 4/468, 2/373 e 4/413 në Drejtorinë e ALUIZNI-t Tërana 1 janë sipas lidhjes I, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

8. Gjenealitetet e poseduesve të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 3/361 e 7/259 në drejtoritë e ALUIZNI-t Tërana 1 dhe Elbasan, janë sipas lidhjes J, që i bashkëlidhet këtij vendimi.



9. Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 436/142e 1/520 në Drejtorinë e ALUIZNI-t Tërana 1, janë sipas lidhjes K, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

10. Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 17/218, 10/338, 23/78, 2/369 e 136/194 në drejtorinë e ALUIZNI-t Elbasan, Durrës, Tërana 2 dhe Tërana 1, janë sipas lidhjes L, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

11. Gjenealitetet e poseduesit të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë për parcelën ndërtimore me nr. pasurie 4/501 në Drejtorinë e ALUIZNI-t Durrës janë sipas lidhjes M, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

12. Gjenealitetet e poseduesit të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë për parcelën ndërtimore me nr. pasurie 9/469, 7/123, 3/121 e 6/786 në drejtorinë e ALUIZNI-t Tërana 1, Elbasan dhe Durrës janë sipas lidhjes N, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

13. Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 9/541 e 8/685 në Drejtorinë e ALUIZNI-t Tërana 1, janë sipas lidhjes O, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

14. Gjenealitetet e poseduesit të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 6/793, 14/30 e 3/155 në drejtorinë e ALUIZNI-t Durrës dhe Elbasan, janë sipas lidhjes P, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

15. Gjenealitetet e poseduesit të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 17/106, 1/83 e 5/814 në drejtorinë e ALUIZNI-t Durrës dhe Tërana 1, janë sipas lidhjes Q, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

16. Gjenealitetet e poseduesit të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 9/446, 8/514, 7/421, 9/575, 19/253, 14/237, 9/95, 8/120 e 530/77 në drejtorinë e ALUIZNI-t Tërana 1, Elbasan dhe Tërana 5, janë sipas lidhjes R, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

17. Gjenealitetet e poseduesit të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 1/539 e 3/515 në drejtorinë e ALUIZNI-t Tërana 1 dhe Korçë, janë sipas lidhjes S, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

18. Gjenealitetet e poseduesit të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 5/1338 e 29/181 në Drejtorinë e ALUIZNI-t Durrës, janë sipas lidhjes V, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

19. Gjenealitetet e poseduesit të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë për parcelën ndërtimore me nr. pasurie 7/252 në Drejtorinë e ALUIZNI-t Durrës janë sipas lidhjes AC, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

20. Gjenealitetet e poseduesit të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë për parcelën ndërtimore me nr. pasurie 1/321 në Drejtorinë e ALUIZNI-t Durrës, janë sipas lidhjes AH, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

21. Gjenealitetet e poseduesit të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë për parcelën ndërtimore me nr. pasurie 8/657 në Drejtorinë e ALUIZNI-t Tërana 1, janë sipas lidhjes AI, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

22. Gjenealitetet e poseduesit të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë për parcelën ndërtimore me nr. pasurie 5/324 në Drejtorinë e ALUIZNI-t Tërana 2, janë sipas lidhjes AJ, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

23. Gjenealitetet e poseduesit të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë për parcelën ndërtimore me nr. pasurie 5/328 në Drejtorinë e ALUIZNI-t Tërana 2, janë sipas lidhjes AK, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



LISTA EMËRORE SIPAS DREJTORIVE RAJONALE PËR KORRIGJIM

LIDHJA B									
NR. RENDOR	DREJTORIA	KORRIGJIMI	EMËR	ATËSI	MBIEMËR	NR. I PROTOKOLLI I VETËDEKLARIMIT PËR LEGALIZIM	ZONA KADASTRALE	NUMRI I PASURISË	SIPËRFAQJA E PARCELËS NDËRTIMORE PËR KALIM PRONËSIE (m²)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	11
1	DURRËS	ISHTE	ILIR	NIKOLL	DOCI	2152	8517	157/239	396.41
		BËHET	ILIR	NIKOLL	DOCI	2152	8517	157/240	433
2	SHKODËR	ISHTE	ARIF	HAJDAR	PAPAJ	448	8591	10/382	318
		BËHET	ARIF	HAJDAR	PAPAJ	448	8591	10/417	438.5
3	SHKODËR	ISHTE	DRITAN	NDOC	NDREU	205	8591	10/357	300
		BËHET	DRITAN	NDOC	NDREU	205	8591	10/422	500
4	SHKODËR	ISHTE	FRROK	GJON	KOLA	109	8591	10/360	300
		BËHET	FRROK	GJON	KOLA	109	8591	10/423	250
5	SHKODËR	ISHTE	GEG	MARK	MANI	457	8591	10/342	300
		BËHET	GEG	MARK	MANI	457	8591	10/420	500
6	SHKODËR	ISHTE	GJON	PAL	MANI	456	8591	10/344	371
		BËHET	GJON	PAL	MANI	456	8591	10/419	500
7	SHKODËR	ISHTE	KUJTIM	NDOC	ALIAJ	209	8591	10/323	300
		BËHET	KUJTIM	NDOC	ALIAJ	209	8591	10/424	500
8	SHKODËR	ISHTE	MARK	PAL	MANI	534	8591	10/341	300
		BËHET	MARK	PAL	MANI	534	8591	10/418	145
9	SHKODËR	ISHTE	NDOC	KOLE	ALIAJ	210	8591	10/365	148
		BËHET	NDOC	KOLE	ALIAJ	210	8591	10/425	90.6
10	SHKODËR	ISHTE	NDUE	MURREC	DEMA	48	8591	10/355	300
		BËHET	NDUE	MURREC	DEMA	48	8591	10/421	430
11	SHKODËR	ISHTE	ZYHDI	HAJDAR	BASHKU	77	8591	10/334	300
		BËHET	ZYHDI	HAJDAR	BASHKU	77	8591	10/416	500
12	TIRANA 5	ISHTE	NDUE	GJERGJ	LUKA	1301	2884	1455/134	500.9
		BËHET	NDUE	GJERGJ	LUKA	898	2884	1455/134	500
LIDHJA C									
13	ELBASAN	ISHTE	PASHO	NASIF	BAJRAMI	2935	8527	303/35	483.7
		BËHET	PASHO	NASIF	BAJRAMI	2935	8527	303/35	483.7
LIDHJA E									
14	ELBASAN	ISHTE	FATMIR	HASAN	VLLAHI	2120	8527	3/153	348.17
		BËHET	FATMIR	HASAN	VLLAHI	2120, 7519, 8743	8527	3/153	204.1
			AHMET	HASAN	VLLAHI				
LIDHJA F									
15	ELBASAN	ISHTE	DHIMITER	KASTRIOT	GEDAJ	658	8523	4/257	196.4
		BËHET	QAZIM	KALEM	PREÇI	4186	8523	4/257	196.4
16	DURRËS	ISHTE	SAFET	VELI	AGOLLI	7202	11/159	8511	527.95
		BËHET	EDUART RRUZHDI	SAFET SAFET	AGOLLI AGOLLI	7202	11/159	8511	527.95
17	TIRANA 1	ISHTE	MENSUR	MUSTAFA	HALILI	385/	8340	4/415	315.4
		BËHET	MENSUR	MUSTAFA	HALILI	385	8340	4/415	315.4
			ARJAN	MENSUR	HALILI				
18	ELBASAN	ISHTE	QAZIM	ISMAIL	HAMATI	928	2124	112/11	478.1
		BËHET	QAZIM	ISMAIL	HAMATI	928	2124	99/10	338.7
LIDHJA G									
19	TIRANA 1	ISHTE	NAFIZE	AVNI	VASHA	631	8210	7/590	824.8
			XHELAL	HAKI	VASHA				
		BËHET	NAFIJE	AVNI	VASHA	631	8210	7/590	500
			ALFRED	XHELAL	VASHA				
20	TIRANA 1	ISHTE	BASHKIM	QAZIM	KRASNIQI	655, 655/1	8210	2/502	295.3
		BËHET	BASHKIM	QAZIM	KRASNIQI	655, 718, 655/1	8210	2/501	411
21	TIRANA 1	ISHTE	KUJTIM	QAZIM	KRASNIQI	656	8210	2/499	336.9
		BËHET	VIOLLCA	NIKOLLA	KRASNIQI	656, 12_2194879	8210	2/499	271.5
LIDHJA H									
22	TIRANA 1	ISHTE	BAHRI	MYRTEZA	SEJDINI	72	8120	3/191	300.08
		ISHTE	CLIRIM	BAHRI	SEJDINI	767	8120	3/189	80.27
		BËHET	BAHRI	MYRTEZA	SEJDINI	1427, 297,2181031	8120	3/191	367
23	TIRANA 1	ISHTE	FERDINAND	QAMIL	BAMKOLLARI	968	8120	8/904	210.9
		BËHET	FERDINAND	QAMIL	BAMKALLARI	968, 1325, 5273, 12_2190321	8120	8/904	195.6
24	TIRANA 1	ISHTE	PAULIN	QIRO	COTA	1059/	8120	8/1265	229.4
			AMARLIN	QIRO	COTA				
		BËHET	AMARILIND	QIRO	COTA	1060	8120	8/1265	229.4
25	ELBASAN	ISHTE	ANDROMAOI	PANDELI	PANXHI	7326	8522	6/248	5



		BËHET	ANDROMAQI	PANDELI	PANXHI	7326	8522	6/248	3.6
			ARDIAN	TOMORR	SUBASHI				
			MIRELA	TOMORR	SUBASHI				
26	ELBASAN	ISHTE	DASHNOR	JAKOV	QOSJA	6630	8525	14/170	90
		BËHET	DASHAMIR	JAKOV	QOA	6630	8525	14/170	90
		ISHTE	DURIM	FASLLI	SHUKA	1597	8525	13/187	284.2
27	ELBASAN	ISHTE	SHEFQET	FASLLI	SHUKA	1596	8525	13/188	280.5
		BËHET	DURIM	FASLLI	SHUKA	1597	8525	13/187	348.5
		BËHET	SHEFQET	FASLLI	SHUKA	1596	8525	13/187	348.5
28	ELBASAN	ISHTE	FAIK	MUSTAFA	ÇILI	8433	8525	7/119	294.7
		BËHET	FAIK	MUSTAFA	ÇILI	8433	8525	7/119	294.7
		ISHTE	KODHEL	ISMAIL	DHOGA	6591	8525	25/135	54.9
29	ELBASAN	BËHET	KODHEL	ISMAIL	DHOGA	6591	8525	25/135	54.9
			SHEQERE	XHELADIN	DHOGA				
			ARTUR	KODHEL	DHOGA				
			MAKSIM		DHOGA				
			ANILA		DHOGA				
30	ELBASAN	ISHTE	MENDU	ASLLAN	BALLA	7496	8525	24/193	155
		BËHET	MENDUH	ASLLAN	BALLA	7496	8525	24/193	87.6
			RAZIJE	DYLBIN	BALLA				
			BUJAR	MENDUH	BALLA				
LIDHJA I									
31	TIRANA 1	ISHTE	NIK	AGRON	QOKAJ	18	3266	400/454	500
		BËHET	NIKE	VUKSAN	QOKAJ	18	3266	17/454	500
			AGRON	NIKE	QOKAJ				
32	TIRANA 1	ISHTE	ARTUR	YZEDIN	ALIBEAJ	1366	8330	4/569	378.74
		BËHET	ARTUR	YZEDIN	ALIBEAJ	1366, 12_2004413	8330	4/569	455.7
33	TIRANA 1	ISHTE	PARTIZAN	HYSEN	MANÇE	337	8210		192.4
		BËHET	PARTIZAN	HYSEN	MANÇE	337, 12_2200786	8210	2/515	192.4
34	TIRANA 1	ISHTE	GENTIAN	ZAKE	BREGASI	248	8330	4/468	499.16
			ERJON	ZAKE	BREGASI				
			EDUART	ZAKE	BREGASI				
			MYRZET	ZAKE	BREGASI				
		BËHET	EDUART	ZAKE	BREGASI	223, 12_2034082	8330	4/468	160.4
		BËHET	GENTIAN	ZAKE	BREGASI	220, 12_2059511	8330	4/468/1	247.6
			ERJON	ZAKE	BREGASI				
35	TIRANA 1	ISHTE	SHERAF	AHMET	BESHIRI	973	8170	2/373	137
		BËHET	SHERAF	HAMET	BESHIRI	973, 429	8170	2/373	245.9
			SHANIKO	HYSEN	BESHIRI				
36	TIRANA 1	ISHTE	GAZMEND	MAL	DRAGOSHI	247	8330	4/413	176.04
			GAZMEN	MAL	DRAGJOSHI				
		BËHET	MAL	NEBI	DRAGJOSHI	247, 12_2007625	8330	4/413	397.2
			XHEVAHIR	MAL	DRAGJOSHI				
LIDHJA J									
37	TIRANA 1	ISHTE	FADIL	SABRI	SIPRI	7	8190	3/361	293
		BËHET	SABRI	FADIL	SIPRI	694	8190	3/361	293
38	ELBASAN	ISHTE	YLLI	NESIM	ÇONIKU	308	1842	7/259	97.6
		BËHET	YLLI	NESIM	ÇONIKU	308	1842	7/259	128.3
LIDHJA K									
39	TIRANA 1	ISHTE	LILI	SHYQYRI	MUÇA	3057	3321	436/142	253
		BËHET	LILI	SHYQYRI	MUÇA	3057	3321	436/142	253
			VAIT	SHYQYRI	MUÇA				
40	TIRANA 1	ISHTE	LUMAN	ABAZ	DINOSHI	722	8240	1/520	181.2
			LUMAN	ABAS	DINOSHI				
		BËHET	SHPENDI	LUMAN	DINOSHI	722	8240	1/519	474.4
LIDHJA L									
41	ELBASAN	ISHTE	DULJAN	XHEVIT	BALLA	5403	8522	17/218	297
		BËHET	DULJAN	XHEVIT	BALLA	1418	8522	17/218	297
42	ELBASAN	ISHTE	ISMET	BAJRAM	ÇELA	342	8523	10/338	487.7
		BËHET	ISMET	BAJRAM	ÇALA	219	8523	10/338	487.7
			ALBERT	BAJRAM	ÇALA				
43	DURRËS	ISHTE	LULZIM	HAJRI	SHEHAJ	4339	8511	23/78	222
		BËHET	LULZIM	HAJRI	SHEHAJ	4339	8511	23/78	303
44	TIRANA 2	ISHTE	HYSNI	QAZIM	KAMBERI	596	8250	2/369	22.8
			KRISTO	JANI	EVANGJELI				
			AGIM	XHAFERR	MANAJ				
			NIKO	KOSTANDIN	ZAKA				
			BAKI	HYDAI	DEMIRAJ				
		BËHET	HYSNI	QAZIM	KAMBERI	596	8250	2/369	28.1
			KRISTO	JANI	EVANGJELI				
			AGIM	XHAFERR	MANAJ				
			ELVIRA	KRISTAQ	ZAKA				
			ALBAN	NIKO	ZAKA				
			INDRIT	NIKO	ZAKA				
			BAKI	HYDAI	DEMIRAJ				
45	TIRANA 1	ISHTE	ASTRIT	JASHAR	DRAGOSHI	2092	3976	136/194	500.0
		BËHET	ASTRIT	JASHAR	DRAGOSHI	2092	3976	136/194	500
			VAHID	JASHAR	DRAGOSHI				



LIDHJA M									
46	DURRËS	ISHTE	ISLAM	RAMAZAN	HUQI	4085	8515	4/501	463
		BËHET	NIKOLIN	FILIP	PRIFTI	4085	8515	4/501	463
LIDHJA N									
47	TIRANA 1	ISHTE	ENVER	MUHARREM	RUSHEKU	1307	8330	9/469	370
		BËHET	ENVERE	MUHARREM	RUSHEKU	1307, 131	8330	9/469	218.6
48	ELBASAN	ISHTE	ARBEN	ASLLAN	KADRIU	5372	8525	7/123	56.2
		BËHET	ARBEN	ASLLAN	KADRIU	5372	8525	7/123	56.2
49	ELBASAN	ISHTE	LULEZIM	ZYLFI	BRAHIMI	132	1842	3/121	161.6
		BËHET	LULËZIM	LYTFI	BRAHIMI	132	1482	3/121	161.6
50	DURRËS	ISHTE	ARDIAN	PETRIT	TRAGAJ	7773	8515	6/786	382
		BËHET	ARDIAN	PETRIT	TRAGAJ	7773	8515	6/786	436
LIDHJA O									
51	TIRANA 1	ISHTE	SMAJL	SHPEND	SELGJEKAJ	221	8330	9/541	365
			ARBEN	ISMAJL	MEHMETI				
		BËHET	SMAJL	SHPEND	SELGJEKAJ	221, 1589,	8330	9/541	365.3
			ARBEN	ISMAJL	MEHMETI	3247,			
52	TIRANA 1	ISHTE	ARJAN	ENVER	PALUSHI	2158	3321	8/685	310
			BËHET	ADRIAN	ENVER	PALUSHI	2158	3321	8/685
		ENVER	NESHAT	PALUSHI					
		LIDHJA P							
53	DURRËS	ISHTE	ARDIAN	PETRIT	TRAGAJ	7774	8515	6/793	572
		BËHET	ARDIAN	PETRIT	TRAGAJ	7774	8515	6/793	690
54	ELBASAN	ISHTE	BASHKIM	NEBI	DEBROVA	7677	8526	14/30	260.2
		BËHET	BASHKIM	NEBI	DEBROVA	7677	8526	14/30	357.9
55	ELBASAN	ISHTE	NAIM	ALI	CANGOJA	3521	8527	3/155	397.8
		BËHET	AGRON	ALI	CANGOJA	7603	8527	3/155	397.8
LIDHJA Q									
56	DURRËS	ISHTE	BARI	DILVER	KIKA	6755	8511	17/106	344
		BËHET	GENCI	IDRIZ	XHEMAJLI	6755	8511	17/106	328
57	DURRËS	ISHTE	ESAT	KADRI	KARASANI	98	8512	1/83	463
		BËHET	FESTIM DHURATA	ESAT ISAK	KARASANI	98	8512	1/83	463
58	TIRANA 1	ISHTE	GJOLEK	REXHEP	AJDINAJ	38	8180	5/814	44
		BËHET	GJOLEK	REXHEP	AJDINAJ	38	8180	5/814	140.4
LIDHJA R									
59	TIRANA 1	ISHTE	VAID	SHAZIMAN	GIXHARI	563/05	8340	9/446	478
		BËHET	VAHID	SHAZIMAN	GIXHARI	563/05	8340	9/446	192.7
			SHKELQIM	SHAZIMAN	GIXHARI	50, 4338	8340	9/446/1	285.6
60	TIRANA 1	ISHTE	SIRI	HIBRO	BIZHGA	4110	8310	8/514	186
		BËHET	SIRI	HIBRO	BIZHGA	4110, 1784,	8310	8/514	186
			MEXHIT	HIBRO	BIZHGA	12_2149998			
61	TIRANA 1	ISHTE	NDRICIM	OSMAN	ISAKU	145	8260	7/421	178
		BËHET	NDRICIM	OSMAN	ISAKU	145, 775,	8260	7/421	134
			JULIAN	NDRICIM	ISAKU	12_3003739			
62	TIRANA 1	ISHTE	SHPETIM		HOXHA	207	8330	9/575	421
			FADIL		HOXHA				
			ARTAN		HOXHA				
		BËHET	ARTAN	FADIL	HOXHA	411, 12_2196470	8330	9/575	421
63	ELBASAN	ISHTE	XHESAMIR	SULEJMAN	KARAJ	6994	8523	19/253	44
		BËHET	XHEVAHIR	SULEJMAN	KARAJ	6994	8523	19/253	44
64	ELBASAN	ISHTE	IBRAHIM	ISLAM	DURAKU	5916	8525	14/237	297.3
		BËHET	IBRAHIM	ISLAM	DURAKU	5916, 5917	8525	14/237	297.3
			XHEVAHIR	IBRAHIM	DURAKU				
65	ELBASAN	ISHTE	ALBAN	ISLAM	SHALA	173	2908	9/95	257.2
		BËHET	ALBAN	ISLAM	SHALA	173	2908	9/95	257.2
			ISLAM	QAMIL	SHALA				
66	ELBASAN	ISHTE	RAMAZAN	ISMAIL	LILA	307	2908	8/120	78.1
		BËHET	VIKTOR	NAMIK	HAXHIRAJ	307	2908	8/120	111.9
			ETLEVA	RAMAZAN	HAXHIRAJ				
67	TIRANA 5	ISHTE	OSMAN	SALI	CERPJA	5112	2884	530/77	137
		BËHET	SELIM	SALI	CERPJA	5762	2884	3/5	107
LIDHJA S									
68	TIRANA 1	ISHTE	AGIM	BASHKIM	HERENI	271	8340	1/539	499
			RAIF	AGIM	HERENI				
		BËHET	AGIM	BASHKIM	HERENI	271, 12_2175235	8340	1/539	499
			RAIF	AGIM	HERENI				
69	KORÇE	ISHTE	SHKELQIM	SULO	DERVISHI	A-141	2573	3/515	500
			ADEM	SHKELQIM	DERVISHI				
			DHIMITRI	THIMI	DERVISHI				
			BEKIM	SHKELQIM	DERVISHI				
			ARISTOTEL	SHKELQIM	DERVISHI				
		BËHET	THIMI	SULO	DERVISHAJ	A-141	2573	3/515	500



			ADEM	SHKELQIM	DERVISHLLARI				
			DHIMITER	THIMI	DERVISHAJ				
			BEKIM	SHKELQIM	DERVISHI				
			ERMIR	SHKELQIM	DERVISHLLARI				
LIDHJA V									
70	DURRËS	ISHTE	ADRIATIK	RUSHAN	LAME	3627	8515	5/1338	442
		BËHET	STEFAN	KRISTO	JANAQI	3627	8515	5/1338	442
71	DURRËS	ISHTE	FATMIR	AHMET	LUKU	6017	8518	29/181	268
		BËHET	FATMIR	AHMET	LUKU	6017	8518	29/181	366
LIDHJA AC									
72	DURRËS	ISHTE	BAHRI SHABAN	ISLAM	DEDEJ	4763	8518	7/252	554
				ISLAM	DEDEJ	3260			
		BËHET	BAHRI SHABAN	ISLAM	DEDEJ	4763	8518	7/252	526
				ISLAM	DEDEJ	3260			
LIDHJA AH									
73	DURRËS	ISHTE	SKENDER	ALUSH	ABDYLI	5324	8511	1/321	521
		BËHET	FLAVIO	SKENDER	ABDYLI	5324	8511	1/876	521
			ROMINA	SKENDER	ABDYLI				
LIDHJA AI									
74	TIRANA 1	ISHTE	ARBEN	ZAIM	VELIAJ	1425	8310	8/657	55
		BËHET	ARBEN	ZAIM	VELIAJ	1425	8310	8/638	99
LIDHJA AJ									
75	TIRANA 2	ISHTE	ARJAN	SULEJMAN	SULA	17	8140	5/324	51
			BESNIK	AVDI	BREGU				
			LAVDIM	DEMIR	ÇIONIKU				
			KAMBER	ABDULLA	QORDJA				
			BASHKIM	XHEVAT	ÇADRI				
		BËHET	ARJAN	SULEJMAN	SULA	17	8140	5/324	51
			BESNIK	AVDI	BREGU				
			LAVDIM	DEMIR	ÇIONIKU				
			KAMBER	ABDULLA	QORDJA				
			RAMAZAN	MEHMET	ÇADRI				
			TATJANA	NAUM	ÇADRI				
LIDHJA AK									
76	TIRANA 2	ISHTE	LUTMIRA	PREL	MARKU	1203	8260	5/328	9
		BËHET	LUTMIRA	PREL	MARKU	1203	8260	5/328	9
			ILIRJAN	HEKURAN	ISAJ	1508			

VENDIM**Nr. 109, datë 10.2.2016**

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 238, DATË 23.3.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPALLJEN E QENDRËS HISTORIKE TË QYTETIT TË KORÇËS DHE MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ADMINISTRIMIN E SAJ”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 29, pika 4, e 53, pika 2, të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në rregulloren për administrimin e Qendrës Historike të qytetit të Korçës, miratuar me vendimin nr. 238, datë 23.3.2011, të Këshillit të Ministrave, fjalë e fundit, e nenit 11, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Kriteret e shfrytëzimit të monumenteve të kulturës përfshirë, “Pazarin e Korçës”, përcaktohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, në përputhje me ligjin nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar. Aktivitetet që do të zhvillohen në to miratohen me vendim të Këshillit të Bashkisë Korçë, në bazë të këtyre kriterëve.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 110, datë 10.2.2016**

PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË Z. FADIL CANAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, dhe në vijim të shkronjës “c”, të pikës 9, të vendimit nr. 33, datë 20.1.2016, të Këshillit të



Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2016”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të z. Fadil Canaj, në masën 1 059 800 (një milion e pesëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale përkatëse të institucionit të mjekimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësinë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

UDHËZIM

Nr. 3, datë 10.2.2016

**PËR FORMATIN E AKTIT TË
KONSTATIMIT, PROCESVERBALIT TË
GJOBËS DHE AKTIT TË KONFISKIMIT
TË AMLF-së**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 53, pika 9 të ligjit nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, ministri i Financave

UDHËZON:

1. Miratimin e formatit të aktit të konstatimit, procesverbalit të gjobës dhe aktit të konfiskimit që mbahet nga inspektorët e AMLF-së, në zbatim të ligjit nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Udhëzimi nr. 7, datë 22.1.2009, “Për formatin e gjobave”, shfuqizohet.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani



FORMULAR

REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E FINANCAVE

AUTORITETI I MBIQYRJES SE LOJRAVE TE FATIT

Adresa: Blv "Deshmoret e Kombit", Tirane, e-mail: sekretaria@amlf.gov.al ; web: www.amlf.gov.al

AKT- KONSTATIMI

I mbajtur sot më datë ____/ ____/____, nga grupi i kontrollit të Autoritetit i Mbikqyrjes së Lojrave të Fatit ndaj subjektit _____ me adresë qendrore _____, dhe me NIUS. _____ me aktivitet,

me adresë sekondare _____ të qarkut (bashkia/njësia administrative) _____, dhe Nr serie të NIUS sekondar _____ ku u konstatua se :

Në mbështetje të ligjit Nr.155/2015 "Për Lojrat e Fatit në Republikën e Shqipërisë", neni _____, pika _____, gërma _____, për sa u konstatuan më sipër:

Akti i Konstatimit mbahet në tre kopje, nga të cilat njera i lihet subjektit.

Për subjektin

(_____)

Për AMLF

1. _____
2. _____
3. _____



FORMULAR

REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E FINANCAVE

AUTORITETI I MBIKQYRJES SE LOJRAVE TE FATIT

Adresa: Blv "Deshmoret e Kombit", Tirane, e-mail: sekretaria@amlf.gov.al; web: www.amlf.gov.al

AKT- KONFISKIMI

I mbajtur sot më datë ____ / ____ / ____, nga grupi i kontrollit të Autoritetit të Mbiqyrjes së Lojrave të Fatit ndaj subjektit _____ me adresë qendrore _____, dhe _____ me NIUS. _____ me _____ aktivitet,

me adresë sekondare _____ të qarkut (bashkia/njësia administrative) _____, dhe Nr serie të NIUS sekondar _____ ku u konstatua se :

Ne mbështetje të ligjit Nr.155/2015 "Për Lojrat e Fatit në Republikën e Shqipërisë", neni _____, pika _____, gërma _____, për sa u konstatuan më sipër:


Akti i Konfiskimit mbahet në tre kopje, nga të cilat njera i lihet subjektit.

Për subjektin

(_____)

Për AMLF

1. _____
2. _____
3. _____



**URDHËR****Nr. 1248, datë 12.2.2016****PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të nenit 27, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë nga data 15.2.2016 deri në datën 17.2.2016, zëvendësministrit të Drejtësisë z. Arben Isaraj.

2. Ngarkohet zëvendësministri i Drejtësisë, z. Arben Isaraj për zbatimin e këtij urdhri.

3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË**Ylli Manjani****KËRKESE**

Shtetasi Isa Harizaj, i datëlindjes 7.11.1964, lindur në Fier dhe banues në Orikum, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, shpalljen të vdekur të motrës së tij, shtetases Valbona Azem Harizaj, e datëlindjes 23.1.1973.

KËRKUES**Isa Harizaj**

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 224 lekë